



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2024

SHKOLLA, MJEDISI I SHOQËRIZIMIT DHE MËSIMIT

Natasha Poroçani*, Helena Grillo **

Departamenti i Gjuhës Shqipe, Fakulteti i Edukimit, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Përmbledhje

Shkolla është mjedisi ku nxënësit e mësuesit shoqërizohen me njëri tjetrin dhe mes tyre, por edhe vendi specifik për të siguruar procesin e të mësuarit, të cilin e ka prioritetin kryesor. Vlera e saj mjedisore perceptohet dhe aplikohet në tri akse: në mjedisin fizik (vendi konkret), biologjik (me karakteristikat që vlerësojnë edhe mirëqenien fiziologjike të gjithëkujt që bën pjesë) dhe antropologjik (vendi në kuptimin antropologjik, pra kulturor etj., kështu siç edhe studiohet nga shkenca të ndryshme sociale).

Në këtë kuadër, kemi synuar të realizojmë një studim teorik mbi shkollën shqiptare në fokus të shoqërimit dhe veprimtarisë edukative nëpërmjet *qëllimshmerisë edukative*, e cila ndërton optikën e pedagogjisë dhe didaktikës.

Metodologjia e ndërtimit strukturor të punimit mbështet kryesisht në prurjet më bashkëkohore të teorisë pedagogjike dhe didaktike, të cilat përbëjnë boshtin diakronik të vlerësimit në raport me gjendjen reale të tri komponentëve me të cilat finalizuam konceptin “shkollë” në kurrikulën shqiptare.

Rrafshet e analizës krahasuese përfshijnë: autonominë e shkollës; kërkimin dhe rikrijimin; këshillin e klasës; përmbajtja e kontratave formuese; procesi edukativ; dianmikrat e grupit; marrëdhëniet edukative.

Në përfundim kemi argumentuar së një edukim i qëllimshëm, mbi të cilin ndërtohet sistemi kurrikular i shkollës në përgjithësi dhe shkollës shqiptare në veçanti, sigurohet përmjes aplikimit të *Cooperative Learning*, ndërvarësisë pozitive, dhe ndarjes së të mësuarit, rezultateve, kërkimeve.

Fjalë çelës: *shkollë, qëllim, edukim, mjedis, arritje*

THE SCHOOL, ITS SOCIAL AND LEARNING TERRITORY

Abstract

The school is the environment where pupils and teachers socialize with each other, but its main purpose is to be the particular place where learning process takes place. The environmental value is

perceived and applied within three axes: the physical environment (the actual place where learning happens), biological (equipped with its characteristics that value the physiological wellbeing of participants) and the anthropological environment (the cultural place according to other social sciences). We aimed to bring a theoretical study on Albanian school focusing on the socialization and educative activity through the educative deliberation which constructs the optics of pedagogy and didactics.

The methodology of structural construction of the study relies on the contemporary approaches of pedagogic and didactic theories, which comprise the diachronic axis of evaluation in relation to the real condition of the three components, finalizing the concept of “school” in Albanian curriculum. The comparative analysis included the school autonomy, research and creativity, classroom council, content of forming contracts, state exams, educative process, group dynamics, and educative relations. We finally concluded that a purposeful education used to construct the curriculum school system in general and Albanian school in particular, is achieved through application of *Cooperative Learning*, positive interdependence, dissemination of learning, results, and research.

Key words: *school, purpose, education, environment, achievement*

Hyrje

Shkolla është mjedisi ku nxënësit e mësuesit shoqërizohen me njëri tjetrin dhe mes tyre, por edhe vendi specifik për të siguruar procesin e të mësuarit, të cilin e ka prioritetin kryesor. Vlera mjedisore e shkollës perceptohet dhe aplikohet në tri akse: *në mjedisin fizik* (vendi konkret), *biologjik* (me karakteristikat që vlerësojnë edhe mirëqenien fiziologjike të gjithëkujt që bën pjesë) dhe *antropologjik* (vendi në kuptimin antropologjik, pra kulturor etj., kështu siç edhe studiohet nga shkenca të ndryshme sociale).

Shkolla është veprimtaria edukative që në vetvete realizohet e karakterizuar nga *qëllimshmëria* e edukimit, e cila ndërton optikën e pedagogjisë dhe didaktikës.

Baza teorike dhe metodologjike e qasjes ndaj problemit kryesor

Mësuesi është ai që promovon dhe orientation sjelljen e nxënësit. Është ai që zotëroin iniciativën në situata edukative, në hapësirën e shkollës tradicionale. (Postic, M., 1983) Ky është një autoritet që duhet përdorur në mënyrën më të mirë, duke u vënë në shërbim të nxënësit. *Qëllimshmëria e edukatorit ndërthehet në të kuptuarit e asaj që kërkon tjetri; në krijimin e njëtrajtshmërisë së kërkesës dhe të të kuptuarit të nxënësit, që do të thotë gadishmëri në ndarjen e pritshmërive, dëshirave, shqetësimeve, entuziazmit nga ana e të edukuarit; nga ana e edukatorit qëllimshmëria shprehet në gadishmërinë për të dëgjuar dhe pranuar atë që nxënësi përshfaq nga vetja, në planin ekzistencial, kulturor dhe intelektual.* (Iori, V., 1988)

Për këtë arsye, një mësues duhet të jetë shumë i përgatitur në planin pedagogjik. *Ajo që didaktikisht kërkohet nga një mësues nuk është të dijë në mënyrë perfekte përgjigjet e pyetjeve të testit, por të dijë si të bëjë pyetjet e duhura, për të ndihmuar në nivel konceptualizimi dhe komunikimi nxënësin.* (Rossini, M., 1988)

Më tepër se sa t'i mësojë, ai duhet t'i lejojë nxënësit të identifikojnë vetë problemet, të stimulojë aktivitetin e nxënësit ndërsa e udhëheq atë. (Postic, M., 1983)

Puna e ndërtuar në këtë mënyrë fiton vlera jo aq të matura me një notë, por të klasifikuara në përvojë. Për më tepër, në këtë mënyrë, puna e zhvilluar nga nxënësi do të bëhet shpërblyese dhe stimuluese vetëm nëse ai vendoset para pyetjeve të tilla të cilat çdo ditë mund të zhvillojnë një copëz të së vërtetës. *Marrëdhënia nxënës-mësues duhet të ndërtohet nga prania e një aktiviteti grupi të barabartë*

si dhe nga cilësia e ndërhyrjes së mësuesit. Pritshmëritë dhe vlerësimet vijnë në këtë mënyrë, qoftë nga mësuesi, qoftë nga grupi i nxënësve; sjellja e një nxënësi determinohet qoftë nga imazhi i sjelljes së shokëve të tij, qoftë nga sjellja e mësuesit. Çdo nxënës përgjatë procesit të ndërveprimit vlerëson rëndësinë që të tjerët i atribuojnë në një rol determinues në një situatë specifike. (Postic, M., 1983) Në këtë mënyrë cilësia e të mësuarit merr vlerë të rëndësishme për klasën. Mësuesi dhe mësimi ndërveprojnë kur logjia e secilit, duke u takuar me tjetrin, di të modifikohet deri në pikën që të mund të ndërtojë me tjetrin diçka të re që nuk do të mund të ishte pa një pikë tranzicioni. (De Giacinto, S., në Iori, V., 1988) Harmonia dhe ankthi transmetohen duke rritur vonesat dhe vështirësitë. Vetëm kur një nxënës të ndjehet i qetë dhe i kthjellët në kërkimin e tij të zhvilluar në mënyrë profesionale e serioze, vetëm atëherë ai do të arrijë rezultatet e duhura. (Rossini, M., 1988)

Për të arritur një raport të mirë me klasën është e rëndësishme që mësuesi të njohë nxënësit. Për të njohur mirë nxënësit shërbejnë momentet e bisedave personale mes tyre, sepse lejojnë të formohet një imazh ideal i subjektit, mundëson një njohje reale, e cila është e nevojshme për të përmbledhur elementet më të përshtatshme në zhvillimin multilateral të personalitetit të individit. (Mercatali, A., 1991) Çdo nxënës krijon raportet e tij me mësuesin. Ky raport ka përmbajtjet dhe lidhjet e tij dhe në këtë hapësirë sekush mëson të përshtasë nevojat e tij, egzigjencat e tij përballë sjelljes së tjetrit. (Postic, M., 1983)

Për të vështuar sinkronikisht në hapësirën e shkollës sonë këtë ekzigjencë funksionale, rrafshet e analizës krahasuese që kemi përdorur përfshijnë: autonominë e shkollës; kërkimin dhe rikrijimin; Qeverinë e Nxënësve; përmbajtja e kontratave formuese; procesin edukativ; dinamikat e punës në grupe dhe marrëdhëniet edukative në këto kontekste.

Siç vërehet, metodologjia e ndërtimit strukturor të punimit është mbështetur kryesisht në prurjet më bashkëkohore të teorive pedagogjike dhe didaktike, të cilat përbëjnë boshtin diakronik të vlerësimit në raport me gjendjen reale të tri komponentëve me të cilat finalizuam konceptin “shkollë” në kurrikulën shqiptare.

Autonomia e shkollës shqiptare

Autonomia e shkollës duhet të konfigurojë fizionominë e vetë shkollës në mënyrë krejt të ndryshme krahasuar me të shkuarën; duhet të konsiderohet në dimensionet dhe përfshirjet e saj të larmishme: të përgjithshme, etiko-politike, ekonomike, socio-kulturore, dhe didaktike.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit ka avancuar dukshëm në dekadën e fundit. Këtë arritje e njeh edhe Progres Raporti më i fundit i BE-së, i cili vlerëson, se *nisur nga perspektiva e legjislacionit arsimor, Shqipëria është mjaft e përgatitur për anëtarësim në BE*. Këtë legjislacion e përbëjnë disa ligje-kornizë:

Ligji Nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar;

Ligji Nr. 15/2017 ‘Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë’,

Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 ‘Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve’, i ndryshuar

si dhe disa ligje të tjera të ndërlidhura me administrimin e sistemit të arsimit. Ligji Nr. 69/2012 ‘Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, u ndryshua në vitet 2015 dhe 2018, si dhe u miratuan një sërë aktesh nënligjore, duke përfshirë Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), urdhra dhe udhëzime të Ministrisë dhe, prej të cilave, vlen të përmenden disa:

Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor;

VKM-ja Nr. 98, datë 27.02.2019, për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Siguri-

mit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP);

VKM-ja Nr. 99, datë 27.02.2019 Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, dt. 19.09.2018 për organizimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe mënyrën e trajnimit e të certifikimit të tyre;

Udhëzim Nr. 13, datë 22.05.2019 për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

Ndryshimet legislative kanë qenë kryesisht në funksion të përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-2020, duke krijuar kushte për zbatimin e reformave të rëndësishme si: *kurrikula e bazuar në kompetenca, rekrutimi transparent dhe i bazuar në meritë të mësuesve, struktura e re qeverisëse e sistemit të arsimit parauniversitar, si dhe përmirësimi i shërbimit në arsim për qytetarët.*

Kjo bazë ligjore siguroi autonominë në këto aspekte:

të përgjithshme: shkolla si institucion i vetëm, i besohet asaj vetë në menaxhim dhe evolucion;

etiko-politike: shkolla është një shërbim që gjen te njeriu dhe komuniteti vlerat e saj;

ekonomike: shkolla përballet me ekonominë e tregut dhe kontekstet kompetitive;

didaktike: shkolla ka detyrimin të aktualizojë bashkëmbardhënien mes asaj që është lokale me atë që është globale; mes jetës dhe universit disiplinaro-kulturor.

Por mungon ndërkohë: autonomia e brendshme kurrikulare; ekonomike, politike dhe ndërmjetësuese.

Ende ligjshmëria nuk e ka përsosur këtë hapësirë, pavarësisht arritjeve në vite. Brenda funksioneve të saj prioritare, autonomia e shkollës shfaq si imperativ, përmirësimin e kësaj hapësire në disa nga komponentët më të rëndësishëm që venë theksin te demokratizimi: krijimi dhe rikrijimi funksional.

Kërkimi dhe rikrijimi

Kërkimi dhe rikrijimi (këtej e tutje K. & R.) është një formë kërkimi bazuar në operatorë praktikë mbi vetë praktikat. Është një formë e pjesëmarrjes dhe e demokratizimit të kërkimit edukativ me synim përmirësimin e vetë përvojës edukuese. Është një formë kërkimi autorefleksiv e ndërmarrë nga ata që janë pjesëmarrës të situatave sociale (përfshirë ato edukative) me qëllim përmirësimin e logjikës, formimit dhe pjesëve të 1) praktikave sociale apo edukative; 2) të të kuptuarit të këtyre praktikave; 3) situatave në të cilat këto praktika marrin jetë. K. & R. është formë e kërkimit pedagogjik që i beson kontrollin e reformave edukative atyre që janë të përfshirë. Në parim një kontroll i tillë mund të ndahet në mënyrë bashkëpunuese nga grupe mësuesish, nxënësish, përgjegjës të shkollave, prindër etj. Në fakt, pjesa më e madhe e projekteve të kërkimit dhe rikrijimit kanë përfshirë në shkollën tonë dy ose tre nga këto grupe. Por ky nuk është vetëm një problem shqiptar, siç e gjejmë të pohuar nga Husen & Neville. (T.Husen & T. Neville, 1985)

Ne do të sjellim vetëm disa nga përbërësit themelorë të K. & R. në shkollë, referuar Becchit i cili përmend si protagonistë të K. & R. jo vetëm mësuesit, pedagogjistët dhe mentorët, por edhe shkencëtarët apo subjektet pedagogjike të përfshirë në proces. Në këtë mënyrë K. & R. bëhet kolektiv dhe nuk është një veprim solitar, por pjesëmarrës, përmes personave që punojnë për të përmirësuar kompetencat e veta dhe të kolegëve.

A është Rrethi Profesional i shkollave tona i përputhshëm me gjithë sa percepton dhe integron në vetvete K. & R.?

Për të qenë më të aktualizuar, iu drejtuam zyrtarisht Rrjeteve profesionale, të mësuesve në disa nga qytet e Shqipërisë, ku kërkuam një definicion të plotë sipas tyre të K. & R. Nga ky kërkim volëm këto përfundime:

Tiranë:

K. & R. është një praktikë në shërbim të ndryshimeve mësimore; K. & R. do të thotë të planifikosh dhe vlerësosh ndryshimin për të përmirësuar zgjidhjet e problemeve mësimore dhe sociale; një lloj kërkimi i aplikuar që diferencohet nga pjesëmarrësit e tjerë aktivë përgjatë proceseve shkollore. Ka si qëllim të modifikojë disa disa kushte dhe kriteret në bashkëmarrëdhëniet mësues-nxënës-komunitet.

Elbasan: K. & R. është një lloj anketimi dhe vetëzhvillimi profesional që shoqërohet me autorefleksion nga ana e pjesëmarrësve në procesin e edukimit. Qëllimi i tij është të kontekstualizojë dhe përsosë mësimdhënien përmes metodave me në qendër nxënësin.

Durrës: K. & R. do të thotë të planifikosh dhe vlerësosh ndryshimet në sistemin shkollor (përfshirë përbërësit e tij), për të përmirësuar dhe arritur zgjidhjet e problemeve. Është gjithashtu një lloj kërkimi për të përcaktuar zgjidhjet e formave të ndryshme të dukurive sociale, mësimore dhe kulturale.

Vlorë: K. & R. synon të kontribuojë në kohë reale për zgjidhjen e problemeve mësimore praktike dhe teorike të shfaqura përgjatë procesit të gjithanshëm shkollor, por edhe në situata specifike. Ai ka për qëllim arritjen e objektivave shkollore nëpërmjet instrumenteve të ndryshme brenda kontekstit social të sistemit shkollor, në bashkëpunim me gjithë aktorët e këtij sistemi e procesi.

Për ta përmbledhur, nga një analizë e thellë e përfundimeve të mësipërme na shfaqen tri koncepte të konsideruara karakteristike:

-Rrjetet profesionale i referohen kryesisht *zhvillimit profesional*; - K. & R. shihet i lidhur ngushtë me *ndërhyrjet didaktike*; - bashkëpunimi është *instrument* për arritjet e efektshme.

Ndërsa ne do të shtonim disa nga instrumentet për efekshmërinë e K. & R.: *ditari, analiza e dokumenteve, pyetësorë, bashkëbisedime, studime rasti, shënime anegdodike, shënime, metoda sociometrike, vëzhgime të jashtme, situata trekëndëshe, fotografi, video, rrjete sociale.*

Qeveria e Nxënësve

Qeveria e Nxënësve (këtej e tutje QN) është një strukturë organizative e pavarur e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e masës së nxënësve për çështjet e shkollës, mësimin dhe edukimit të tyre dhe mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Neni 12.



Sipas Gori&Tanga, strukturimi i brendshëm i QN janë:

Problem solving: problem finding; problem solving/decision making;

-centralizimi i detyrave të nxënësve: konjitive, emotive, pedagogjike, organizative etj.;

-planifikimi: qartësia, saktësia, objektiviteti. Optika e planifikimit mund të ndërtohet si një optikë e vërtetë sipërmarrjeje që sjell individualizimin dhe investimin e asteve dhe kompetencave;

-sistemimi: QN është një sistem që vepron sidomos në brendësi të shkollës, e cila vetë është një sistem kompleks, në cilësinë e saj të hapur së brendshmi. Vetë Arsimi Parauniversitar është sistem projektsh. Të kontraktosh sistemin në optikën e sistemit, përcjell impenjim vëmendje për të gjithë komponentët e nënsistemeve të sistemit në terma të qasjes profesionale, organizative, humane, interaktive, interdisiplinare, sinergjike, egzigjencave, problematikave etj.;

-cilësia totale: vëmendje ndaj vlerave të ndara ose të privileguara zakonisht; proceseve dhe jo vetëm produkteve; efijencës së qarkullimit të vlerave, transparencës dhe efikasitetit të komunikimit.

Kjo perspektivë kaq e thelluar, në QN në ligjshmërinë tonë ravijëzohet:

Qeveria e nxënësve, si një strukturë e pavarur, kontraktin respektimin e roleve, duke marrë përgjegjësitë; duke aktivizuar sipas modaliteteve specifike në kontekste situacionale prezente, të varieteteve të ndryshme; siguron që të jenë realisht të njohura e të pranuar të drejtat e nxënësve nga aktorët e tjerë të procesit; zotëron dhe kërkon qartësinë e rolit të të gjithë aktorëve të përfshirë në proces.

Pjesa tjetër e ligjshmërisë merret me detyrat e kryetarit dhe anëtarëve të saj, të cilat kanë më shumë natyrë administrative.

Përmbajtja e kontratës formuese të mësuesit (trajnuese)

Me Kontratë Formuese nënkuptojmë tërësinë e angazhimeve të ndërsjella që mësuesit dhe prindërit marrin përsipër për të siguruar që çdo fëmijë të ketë një përvojë pozitive mësimi dhe socializimi në mjedisin shkollor. Elementet thelbësore të Kontratës së Trajnimit janë qartësia e qëllimit, ndarja, pranimi i ndërgjegjshëm dhe marrja e përgjegjësisë nga secili prej komponentëve të përfshirë në veprimin e trajnimit.

Kjo arrihet përmes një procesi të njohjes dhe vlerësimit të ndërsjellë të rolit të vet edukativo-trajnuese, ndërmjet shkollës dhe familjes.

Shkolla, familja dhe nxënësit, nëpërmjet angazhimeve të përgjegjshme, kalojnë nga thjesht “të qenit bashkë” në punën e përbashkët në një ecuri të niveleve të pjesëmarrjes, koordinimit të përpjekjeve dhe bashkëpunimit.


Kjo kontratë individuale formimi nuk egziston në përvojën e shkollës sonë.

Procesi edukativ

Procesi edukativ legjitimohet në bazë të faktit që, qoftë në formë apo mënyrë, finalitetet ekstremisht diversifikative, vijnë në të gjitha përmbajtjet humane.

Në procesin edukativ ndërhyjnë fakte dhe akte (edukative). Të parat janë dukuri mjedisore, ndërhyrje. Të dytat janë të përfshirë me ndërhyrje dhe me përgjegjësi nga ai që merr përsipër rolin e edukatorit në një kontekst specifik dhe në përkatësi të disa tipe subjektsh.

Finaliteti i procesit edukativ:



Procesi edukativ konfigurohet si ndërhyrje njohëse dhe modifikuese (rikërkimi) mbi individin dhe

mbi karakteristikat e tij personale, sepse edukimi është ndërhyrje në karakteristikat personale: *konjitive, emotive, madhënisore, të sjelljes*. Ai mbështetet nga instrumente konjitive e komunikuese. Deri në këtë pikë shkolla jonë e siguron këtë lloj strukturimi. Por kurrikula nuk mundëson karakterin gjenerativ të instrumenteve, që do të thotë të sigurojnë një proces i cili të vijojë automatikisht, në mënyrë të pavarur nga shkolla, kurrikula etj.

Instrumentet (asetet informative):

tipologjitë-multimedialiteti, paraqitja dhe demonstrimi, argumentimi;

përdorimi i subvencioneve – të shkruar, multimedialë, ikonografikë, informativë etj.

Në shkollën tonë procesi edukativ dhe formues është sistem: formim i nxënësit, zhvillim profesional i konfiguruar në nënsisteme, individualizim dhe menaxhim i përbërësve të procesit (mësues, nxënës, komunitet etj.) Në këtë sistem funksionojnë grupet, të cilat kanë dinamikën e tyre, e cila determinohet nga *reciprociteti, dualiteti, lëvizshmëria*. Breda grupeve të sistemit dallohet *leadershipi*, cili në shkollën tonë i përket njërës prej tipologjive: ose autoritar, (e trashëguar), ose liberal (më i shpeshtë), ose negociues.

Gjithsesi, procesi edukativ në shkollën tonë është i mbështetur në marrëdhënie, ka në brendësi prezencën reciproke të subjekteve të përfshirë, e cila konkretizohet në reciprocitetin e marrëdhënies.

Cooperative learning

Mbështetur në të dhënat e fundit të Pisa-s sistemi ynë arsimor ka reflektuar probleme cilësore në

formim; dhe relacionet e ndryshme sociologjike e referojnë këtë problematikë edhe në edukim. Si instrument në kapërcimin e këtyre problemeve, ne do të sugjeronim *cooperative learning* (këtej e tutje CL), mjet i cili bashkon kërkimin dhe aplikimin. CL mund të përshkruhet nga dy pikëvështrime të ndryshme: si një lëvizje edukative ose si një metodë didaktiko-edukative. Ne na intereson mbi të gjitha metoda, ndaj dhe si të tillë do ta referojmë. *Dewey pohonte se qëniet njerëzore duhet të mësojnë të jetojnë në komunitet dhe përvojat e tyre duhet të vijnë nga procese bashkëpunimi. Për nxënësit kjo përvojë fitohet në klasë. Jeta në klasë duhet të përfaqësojë procesin demokratik në mikrokozmos dhe zemra e këtij procesi është puna në grup. Dewey mbështeste idenë se jeta e klasës duhet të mishërojë demokracinë, jo vetëm në mënyrën se si nxënësit mësojnë të bëjnë zgjedhjet e tyre apo se si mësojnë të realizojnë projekte akademike së bashku, por në mënyrën se si mësojnë të krijojnë marrëdhënie mes tyre. Kjo qasje mund të përfshijë të mësuarit e empatizimit me të tjerët, duke respektuar të drejtat e tjetrit punën bashkë me synimin problem solving (Schmuck, 1985).*

Duke vlerësuar mendimin e M. Tanga, *Cooperative Learning* mund të përkufizohet si një tërësi e sjelljes në klasë në të cilën nxënësit punojnë në grupe të vogla përgjatë aktivitetit të mësimnxënies dhe marrin vlerësime në bazë të rezultateve të arritura.

Në shkollën tonë, mësimi në grupe është realizuar në mënyrë të pjesëshme, për disa arsye:

- mungesa e mbështetjes me instrumente didaktike;
- mendësia e mësimdhënies, ende e pashtuar ndaj metodave të reja;
- puna në grup- e orientuar në synimet e saj formuese por jo edukative, emaptike e demokratike.

Duke iu referuar shkencëtarëve D.W.Johnson, R.T.Johnson, Holubec, Roy etj., nëse duhet të flasim për grupe efikase në metodën e *Cooperative Learning*, është e nevojshme në përgjithësi prezenca në të e disa karakteristikave të domosdoshme dhe themelore: ndërparësia pozitive, ndërveprimi ballë për ballë, mësimi dhe përdorimi i aftësive sociale të të vepruarit në grupe të vogla heterogjene, përmbledhja dhe kontrolli i aktivitetit nëpërmjet të dëgjuarit dhe vlerësimi individual dhe në grup.

Përfundime:

1. Në shkollën tonë, mungon autonomia e brendshme kurrikulare; ekonomike, politike dhe ndërmjetësuese, të cilën ligjshmëria ende nuk e ka përsosur.
2. Mungon një kontratë trajnimi mes institucionit dhe mësuesit, përpiluar juridikisht mbi ligjshmërinë dhe analizën e nevojave të mësuesit.
3. Qeveria e nxënësve si një institucion demokratik, që i jep zë vullnetit dhe nevojës së protagonistit kryesor të shkollës, nuk e shtjellon as ligjërisht dhe as konkretisht përmasën e një marrëdhënie vërtetë demokratike mes komponentëve të saj, të vendosura në kritere mrëfilli sociale.

Sugjerime

1. Në hapësirën boshe të Kontratave Formuese të mësuesve, të përpilohen me shpejtësi nene e nën nene, në bazë të modeleve që na ofrojnë përvojat didaktiko-pedagogjike bashkëkohore.
2. Për arkitekturën funksionale të Qeverisë së Nxënësve ne sygjerojmë rishikimin e ligjshmërisë dhe neneve që lidhen me këtë institucion, duke fokusuar në të optikën e sistemit, përcjelljen e impenjimeve në vëmendjen e të cilëve të vendosen të gjithë komponentët e nënsistemeve brenda sistemit.
3. Për të siguruar efektshmërinë e procesit edukativ dhe formues duhet të rikonceptohet nga njësitë drejtuese dhe rjetet profesionale të shkollave K&R duke i integruar këto procese edhe në marrëdhëniet sociale e demokratike brenda shkollave.
4. Mbështetur në të dhënat e fundit të Pisa-s sistemi ynë arsimor ka reflektuar probleme cilësore në formim dhe relacionet e ndryshme sociologjike e referojnë këtë problematikë edhe në edukim. Si instrument në kapërcimin e këtyre problemeve, ne do të sugjeronim *cooperative learning*,

mjet i cili bashkon kërkimin dhe aplikimin, në pjesëmarrjen aktive të instrumenteve që e realizojnë atë.

Referenca:

1. A. Mercatali, *Pedagogia, Educare oggi*, La scuola editrice Brescia, Ed-Antonianum, Roma, 1991.
2. E. Becchi, *Ricerca –Azione: riflessioni su voci di dizionari, manuali, enciclopedie*. Scuola e città, Roma, Nr 4, aprile 1992.
3. M Rossini, *Primo non nuocere: ovvero professione insegnante*, Armando, Roma, 1988.
4. M. Gori & M. Tanga, *Metodologia e didattica*, Grifo, Perugia 2000.
5. M. Postic, *La relazione educativa. Oltre il rapporto maestro-scolaro*, Armando, Roma, 1983.
6. P. Meirieu, *Le pedagogie entre le dire et le faire*, ESF Editeur, Paris 1995.
7. Wene e nwn neneL humane, interac suesit, st mbi ligjshmwrinw ve qwndrimti nw Pisa, pwrjetoi njw ringjallje shpirtwrore dhe letrR. A. Schmuck, *The Handbook of Organization Development in Schools and Colleges*, Waveland Pr Inc, 1985.
8. S. De Giacinto, *Educazione come sistema. Studio per una formalizzazione della teoria pedagogica*, Iori, 1988.
9. T. Husen and T. Neville Postlethwaite, editors, *The International Encyclopedia of Education: Research and Studies*, Oxford, New York, Toronto, Sydney, Paris, Frankfurt: Pergamon Press, 1985, 10 volumes, fq. xxvi+5648+ix+419.
10. V. Iori, *Essere per l'educazione. Fondamenti di un'epistemologia pedagogica*, La Nuova Italia, Venezia, 1088.

Ligjshmëria

- European Commission, “Albania 2019 Report - Communication on EU Enlargement Policy,” 2019.
- MASR, Ligj Nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (i azhornuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, MASR, 2019.
- Ligji Nr. 15/2017 për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, 2017.
- Ligji Nr.10 247, datë 4.3.2010 për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 23/2018 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10 247, datë 4.3.2010, “për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.
- MASR, Ligj Nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë (i azhornuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, MASR, 2019.
- MASR, Udhëzim Nr. 13, datë 22.05.2019 për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- QBZ, Vendim i Këshillit të Ministrave për miratimin e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2014-

2020, Tirana, 2016-2.

Udhëzimi nr. 25, datë 02.08.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 22, datë 04.10.2019.

Web-site

<https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

<https://www.mdpi.com/2071-1050/9/6/1036>

<https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>